

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Pajisje dhe orendi mobilimi për objektet arsimore”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mobilime te ndryshme 3939000-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **57,191,100** (pesëdhjetë e shtatë milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e njëqind) **lekë pa tvsh**. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës në Euro është: 570,997.40 (pesëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë presje dyzet) Euro. **Kursi i këmbimit në monedhën Euro, Banka e Shqipërisë datë 08.08.2024, është 100.16 lek**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 "Formulari permbledhes i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë 114,382,200 (njëqind e katërmëdhjetë milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind) lekë pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, te Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore te te ardhurave te tatueshme ne formen e percaktuar ne udhezimin e Ministrit te Financave ne zbatim te ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet tatimore brenda dates 31 mars te vitit pasardhes".*

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël"

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"i ndryshuar;

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas kësteve të parashikuara në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas prane bashkëve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlogaritur fondit limit që prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

a) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues:

a) Një punësim mesatar i të paktën 10 (dhjetë) personave, për 3 muajt e fundit të deklaruar. Me qëllim plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Administrata Tatimore, shoqëruar më listëpagesat e periudhës së kërkuar (të firmosura dhe vulosura nga Administrata Tatimore/ në mënyrë elektronike në përputhje me legjislacionin në fuqi).

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Nga ana e AK është kërkuar një numër punonjësish prej 10 personash, sepse kontrata është komplekse, me shumë artikuj ku kërkohen punonjes të specializuar në procese specifike të prodhimit të mallrave objekt prokurimi. Shume artikuj janë prodhim sipas permasave të percaktuara në planet perkatëse të mobilimit që kërkon precision, cilesi dhe shpejtesi në të njëjten kohë. Të gjithë artikujt janë parashikuar të jenë Furnizim Vendosije, pra përveç prodhimit dhe shpërndarjes kemi të përfshirë edhe procesin e montimit që kërkon punonjes të tjere duke patur parasysh edhe faktin që kemi të bëjmë me ambiente që gjenden në pozicione të ndryshme të Bashkisë Tiranë me largësi të konsiderueshme nga njëri tjetri.

Në bazë të përllogaritjeve, nisur nga sasia e produkteve të kërkuara, nevojitet staf, si më poshtë vijon:

Nisur nga volumi i mallrave, llogariten rrugë transporti me kamionë mbi 1.5 ton, kjo për shkak të distancave të shkollës dhe pozicionit gjeografik të tyre.

Shoferë- 2 persona

Punëtorë ngarkim shkarkimi, montim - 8 punëtorë

Total- 10 punonjes

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës/bashkimi i operatorëve duhet të kenë në stafin e tyre të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme CV, diplomë përkatëse si dhe të rezultojë në listpagesa për 3 muajt e fundit të deklaruar, si më poshtë

- 1 (një) inxhinier druri
- 1 (një) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa për staf është hartuar në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 40, pika 5, (i ndryshuar).Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale,autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) *licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

b) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*

c) *fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

ç) *mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën...."*

Rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me këto kërkesa. Në këtë kontekst, referuar natyrës, vlerës së kontratës dhe objektit të prokuruar autoriteti kontraktor me anë të kërkesës së tij si me lart, e cila është vendosur në përputhje me specifikimet teknike për këtë procedurë, kërkon të garantohet për besueshmerinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Ky kriter lidhet gjithashtu me kapacitetet teknike dhe aftësitë profesionale të operatorëve.

a) Kërkesa për Specialistë të certifikuar garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i

Operatorit Ekonomik është i çertifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin me cilësi dhe në kohë të kontratës në tërësi.

b) Kërkesa lidhet me stafin garantojnë Autoritetin Kontraktor se stafi teknik i Operatorit Ekonomik është i çertifikuar, ka njohuritë e duhura profesionale për realizimin e kontratës.

c) Bazuar në objektin e prokurimit, volumin kërkesa prej të paktën 1 (një) inxhinier drurijanë në përpjestim me natyrën dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese dhe vlerën e kontratës. Prania e inxhinierit të sipërcituar, i jep siguri AK se Operatorit Ekonomik është i çertifikuar, ka njohuritë dhe ekspertizën e duhur profesionale për realizimin e kontratës.

Objekti i procedues se prokurimit “Pajisje dhe orendi mobilimi për objektet arsimore” përfshin në vetvete edhe procesin e prodhimit të mobiljeve pra përmban në vetvete elemente shërbimi për të cilën është e nevojshme që nga ofertuesit e mundshëm ekonomike të disponohet edhe një staf i cili të bëjë të mundur realizimin me sukses të këtij procesi për realizimin e pajisjeve dhe orendi mobimi për objektet arsimore. Punonjësit e kërkuar janë të nevojshëm, duke qënë se kjo procedurë prokurimi ka në përbërjen e saj përvec mallrave edhe transportimin dhe instalimin e disa prej tyre e bën të domosdoshëm kërkesën për disponimin nga ana e ofertuesve të mundshëm ekonomikë edhe të një stafi të konsiderueshëm për realizimin në kohën e duhur të lëvrimin dhe instalimit të tyre pranë objekteve arsimore. Procedura e prokurimit në fjalë, referuar specifikimeve teknike, është lehtësisht e kuptueshme që artikujt objekt prokurimi nuk janë artikuj që gjenden në subjekte tregtare të tilla si pika shitje pasi kanë përmasa dhe specifika të ndryshme referuese dhe duhet të përshtaten me vendet ku do të vendosen/ montohen, pra do duhet të merret serish përmasat dhe të prodhohen në mënyrë që të përshtaten me kërkesat e AK. Për sa më sipër, AK nuk është në gjendje të identifikojë pra nuk ka në staf ekspert të fushës inxhinierë druri për të mundësuar njohjen e saktë të materialit të produktit që do të ofrohet, si dhe ndjekjen hap pas hapi të procesit të prodhimit të tyre konform specifikimeve teknike. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Kërkesa nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e

dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë minimum 2 (dy) mjete transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton të përshtatshëm për transport mallrash. Mjeti i transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.

Pronësia e mjeteve të mësipërme vërtetohet:

- Mjetet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuara (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi)
- Mjetet me qira të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit
- Për mjetet e transportit duhet të paraqiten edhe dokumentet që vërtetojnë regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore)

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Referuar specifikimeve të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend-dorezimit të tyre në destinacionin perkates, pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

Jane kërkuar dy kamion të përshtatshëm për transport mallrash për të vërtetuar që ofertuesit pjesëmarrës kanë automjete të nevojshme për transportin e mallrave, kapacitetet organizative, aftësitë organizative për të zbatuar kontratën, reputacionin dhe besueshmërinë duke qenë se kontrata është komplekse me shumë artikuj të cilat duhet të transportohen dhe të bëhet furnizim vendosja e tyre sipas shkollave të përcaktuara

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen nëpër vende të të gjithë artikujve në adresat e përcaktuara në planin e shpërndarjes.

Për ngjyrat e mobiljeve duhet të kontaktohet paraprakisht Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Ky kriter vendoset në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet pasi mallrat objekt prokurimi duhet të transportohen dhe montohen në të gjithë adresat e përcaktuara në plan shpërndarje.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit nga data e dorëzimit të artikujve), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre, për paisjet që kanë defekte nga prodhimi.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001- 2015** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë **ISO 14001-2015** (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë **OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018** Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (e vlefshme, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë). (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zerave të mallrave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentim: Në bazë të pikës 1 dhe 2, të nenit të 79, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga ana e AK është kërkuar zotërimi i certifikatave:

ISO 9001- 2015 - Certifikate e cilesise se punimeve

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin pajisjet e mobiljeve për nxënësit e arsimit parauniversitar me qëllim furnizimin me pajisje cilësore nisur nga fakti që bëhet fjalë për institucione arsimore dhe nisur nga kohëzgjatja e konsiderueshme që përdoren këto pajisje, vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

ISO 14001-2015 – Certifikate per menaxhimin e sistemit mjedisor

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin prodhimin e pajisjeve të mobiljeve për nxënësit e arsimit parauniversitar dhe duke qenë se ky proces sjell ndikime në mjedis vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 - Certifikate per menaxhimin e sistemit te sigurise dhe shendetit

Duke qenë se objekti i prokurimit në këtë procedurë përfshin një sërë procesesh të cilët kërkojnë cilësi dhe operatorët ekonomikë në këtë fushë duhet të zotërojnë një numër të lartë makinerish dhe duhet të kenë të punësuar kryesisht një numër të lartë punonjësish vlerësohet që zotërimi i një certifikate të tillë është i nevojshëm dhe në përputhje të plotë me natyrën dhe volumin e kontratës që prokurohet.

2.3.11 Operatori ekonomik për artikujt e kërkuar duhet të paraqesë certifikatat e produktit si më poshtë:

- Tavolinë nxënësi cikli i ulët SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 e njëvlefshme ose e përditësuar.
- Tavolinë nxënësi cikli i lartë: SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 , e njëvlefshme ose e përditësuar.

- Karrige nxënësi cikli i ulët : SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 ,e njëvlefshme ose e përditësuar.
- Karrige nxënësi cikli i lartë : SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016, SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 ,e njëvlefshme ose e përditësuar.
- Karrige mësuesi: SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 e njëvlefshme ose e përditësuar
- Tavoline pune : EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, e njëvlefshme ose e përditësuar
- Dollap për klasa (Raft) : SSH EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, e njëvlefshme ose e përditësuar
- Karrige rrotulluese (zyre): SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018 ,e njëvlefshme ose e përditësuar
- Krevat femijesh : SSH EN 1130:2019/ AC:2020, e njëvlefshme ose e përditësuar
- Tavoline kopshti : EN 1729-2012+A1:2015, SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016, SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 , e njëvlefshme ose e përditësuar.

Gjithashtu për të gjitha certifikatat e mësipërme, operatori ekonomik mund të paraqesë certifikata ekuivalente me të njëjten performancë (qëllim certifikues) ose të përditësuara me ato më sipër, sipas standarteve SSH/EN mbi konformitetin e standarteve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë të vlefshme për gjatë periudhës së realizimit të procedurës së prokurimit. Certifikatat e mesiperme duhet të jene origjinale ose të njehsuara me origjinalin (kopje e noterizuar). Certifikatat e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Ne rastet kur oferta dorezohet nga nje BOE, operatorët duhet të disponojnë certifikatat e kerkuara në përputhje me raportin e pjesëmarrjes në furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Tavolinë nxënësi cikli i ulët/cikli lartë SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 e njëvlefshme ose e përditësuar., standart që përcakton dimensionet funksionale të tavolinave për përdorim në institucionet shkollore dhe parashkollore që nga moshën 3-14+, duke bërë një klasifikim sipas ngjyrave në përputhje me moshën dhe gjatësinë e femijëve, në mënyrë që të sigurohet një qëndrim sa më rregullt I femijes.

EN 1729-2:2012+A1:2015, standart që përcakton kërkesat e sigurisë që duhet të përmbushin tavolinat për nxënësit për përdorim në institucionet shkollore dhe parashkollore si dhe përshkruan metodat e testimit që aplikohen për të vlerësuar sigurinë dhe stabilitetin e këtuve mobiljeve.

Është shumë e rëndësishme që mobiljet shkollore të përmbushin këto standarde për arsye si më poshtë vijon:

Siguria: Standardet sigurojnë që mobiljet janë të qëndrueshme dhe të sigurta për përdorim nga nxënësit, duke minimizuar rrezikun e lëndimeve.

Komoditeti dhe Ergonomia: Mobiljet që përmbushin standardet janë të dizajnuara për të mbështetur pozicionin e duhur të trupit, duke ndihmuar në parandalimin e problemeve shëndetësore si dhimbjet e shpinës dhe qafës.

Përshtatshmëria për Moshën: Standardet përcaktojnë dimensionet e duhura për mobiljet në varësi të moshës dhe madhësisë së nxënësve, duke siguruar që çdo nxënës të ketë një mjedis të përshtatshëm për të mësuar.

Qëndrueshmëria: Mobiljet që përmbushin standardet janë të ndërtuara për të qenë të qëndrueshme dhe të rezistojnë ndaj përdorimit të përditshëm në shkolla.

Mbështetja e Procesit të Mësim: Mobiljet e përshtatshme ndihmojnë në krijimin e një mjedisi të rehatshëm dhe të organizuar për nxënësit, duke përmirësuar përqendrimin dhe efikasitetin në mësim.

Karrige nxenesi cikli i ulët/cikli i lartë SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015, standart qe percakton dimensionet funksionale te tavolinave per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore qe nga mosha 3-14+, duke bere nje klasifikim sipas ngjyrave ne perputhje me moshen dhe gjatesine e femijeve, ne menyre qe te sigurohet nje qendrim sa me rregullt I femijes.

SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016 SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015, standart qe percakton kerkesat e sigurise qe duhet te permbushin tavolinat e nxenesve per perdorim ne institucionet shkollore dhe parashkollore qe nga mosha 3-14+, duke bere nje klasifikim sipas ngjyrave ne perputhje me moshen e femijeve,si dhe pershkruan metodat e testimit qe aplikohen per te vleresuar sigurine dhe stabilitetin e ketyre mobiljeve.

Kërkimi i standardeve si SSH EN 1729-1:2015 dhe SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015 keto standarde për arsyet si me poshte vijon:

Ergonomia dhe Shëndeti: Këto standarde sigurojnë që mobiljet shkollore të jenë të dizajnuara në mënyrë ergonomike, duke ndihmuar në parandalimin e problemeve shëndetësore si dhimbjet e shpinës dhe qafës që mund të shkaktohen nga përdorimi i mobiljeve të papërshtatshme.

Komoditeti dhe Përqendrimi: Mobiljet e përshtatshme ndihmojnë nxënësit të jenë më të rehatshëm gjatë orëve të mësim, gjë që mund të përmirësojë përqendrimin dhe performancën akademike.

Siguria: Standardet përfshijnë kërkesa për sigurinë e mobiljeve, duke minimizuar rrezikun e lëndimeve nga përdorimi i tyre.

Përshtatshmëria për Moshën: Këto standarde sigurojnë që mobiljet të jenë të përshtatshme për moshën dhe madhësinë e nxënësve, duke marrë parasysh ndryshimet fizike gjatë rritjes.

Konsistenca dhe Cilësia: Duke ndjekur këto standarde, prodhuesit mund të sigurojnë një nivel të lartë të cilësisë dhe konsistencës në produktet e tyre.

Karrige mesuesi SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe perdoret per te percaktuar kerkesat ne lidhje me dimensionet qe duhet te kete nje karrige per perdorim te zakonshem ne menyre qe te sigurohet nje qendrim i pershtatshem per te punuar dhe gjithashtu pershkruan edhe metodat e testimeve te kryera per percaktimin e tyre. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti i prodhuar respekton keto dimensione.

SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe specifikon kerkesat qe duhet te plotesojne keto karrige per sa i perket sigurise, forces dhe qendrueshmerise per nje perdorim rreth 8 ore ne dite dhe per nje person qe peshon deri ne 110 kg. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti eshte i sigurte per nje perdorim te tille.

Kërkimi dhe zbatimi i standardeve si SSH EN 1335-1:2021 dhe SSH EN 1335-2:2018 është i rëndësishëm për keto arsye:

Siguria dhe Shëndeti: Këto standarde sigurojnë që karriget e punës në zyrë të jenë të sigurta për përdorim të përditshëm, duke minimizuar rrezikun e lëndimeve dhe problemeve shëndetësore si dhimbjet e shpinës dhe qafës.

Komoditeti: Dimensionet dhe dizajni i karrigeve të përcaktuara nga këto standarde ndihmojnë në krijimin e një mjedisi pune më të rehatshëm, duke përmirësuar produktivitetin dhe mirëqenien e përdoruesve.

Cilësia dhe Qëndrueshmëria: Standardet sigurojnë që karriget të jenë të qëndrueshme dhe të kenë një jetëgjatësi të gjatë, duke përmbushur kërkesat për forcë dhe qëndrueshmëri.

Përputhshmëria: Për kompanitë dhe prodhuesit, përputhshmëria me këto standarde është një tregues i cilësisë dhe besueshmërisë së produkteve të tyre, duke ndihmuar në ndërtimin e besimit të konsumatorët.

Ligjshmëria: Në shumë vende, përputhshmëria me standardet e sigurisë është e detyrueshme për të shmangur gjrobat dhe për të përmbushur kërkesat ligjore.

Tavolinë mësuesi: EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, standart që specifikon permasat që duhet të plotesoje produkti.

EN 527-1:2011, SSH EN 527-2:2016+A1:2019, ky standard evropian specifikon kërkesat e sigurisë, forcës dhe qëndrueshmërisë në tavolinat e punës.

Kërkimi dhe zbatimi i standardit **EN 527-1:2011** është i rëndësishëm për keto arsye si me poshte:

Ergonomia: Siguron që tavolinat e punës të jenë të dizajnuara për të përmbushur nevojat ergonomike të përdoruesve, duke reduktuar rrezikun e lëndimeve dhe problemeve shëndetësore të lidhura me punën.

Komoditeti: Ndihmon në krijimin e një mjedisi pune më të rehatshëm dhe produktiv, duke siguruar që tavolinat të jenë të përshtatshme për përdoruesit në pozicione të ndryshme pune.

Siguria: Siguron që tavolinat të jenë të qëndrueshme dhe të sigurta për përdorim, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve në vendin e punës.

Përputhshmëria: Ndihmon kompanitë të përmbushin kërkesat ligjore dhe rregullative, duke shmangur gjrobat dhe problemet e tjera ligjore.

Kualiteti: Siguron që produktet të jenë të një cilësie të lartë dhe të përmbushin pritshmëritë e përdoruesve.

Dollap për klasa SSH EN 14073-3:2004 , SSH EN 14074:2004, Standart që nenkupton që produkti dollap I është nënshtruar testeve që kanë të bëjnë me ushtrimin e forcës dhe peshave të ndryshme që mund të jenë të pranishme gjatë funksionimit normal të dollapit. Gjithashtu testeve

u nenshtrohen edhe pjeset perberese te dollapit. Nje certifikate te tille nenkupton qe dollapi ne teresine e tij ploteson kerkesat e fortesise, rezistences dhe qendrueshmerise.

Kërkimi dhe zbatimi i standardeve si SSH EN 14073-3:2004 dhe SSH EN 14074:2004 është shumë i rëndësishëm për keto arsye si me poshte:

Siguria: Këto standarde sigurojnë që mobiljet të jenë të qëndrueshme dhe të sigurta për përdorim, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve.

Cilësia: Zbatimi i këtyre standardeve ndihmon në garantimin e cilësisë së produkteve, duke siguruar që ato të përmbushin kërkesat e nevojshme për forcë dhe qëndrueshmëri.

Përputhshmëria: Për shumë tregje dhe industri, përputhshmëria me standardet ndërkombëtare është një kërkesë e domosdoshme për të hyrë në treg dhe për të fituar besimin e klientëve.

Karrige rrotulluese SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe perdoret per te percaktuar kerkesat ne lidhje me dimensionet qe duhet te kete nje karrige per perdorim te zakonshem ne menyre qe te sigurohet nje qendrim i pershtatshem per te punuar dhe gjithashtu pershkruan edhe metodat e testimeve te kryera per percaktimin e tyre. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti i prodhuar respekton keto dimensione.

SSH EN 1335-1:2021, SSH EN 1335-2:2018, standart qe specifikon kerkesat qe duhet te plotesojne keto karrige per sa i perket sigurise, forces dhe qendrueshmerise per nje perdorim rreth 8 ore ne dite dhe per nje person qe peshon deri ne 110 kg. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti eshte i sigurte per nje perdorim te tille.

Keto standarte shoqerohen bashke. Nje certifikate e tille nenkupton qe mobilja e prodhuar i ploteson keto standarte.

Kërkimi i standardeve si SSH EN 1335-1:2021 dhe SSH EN 1335-2:2018 është shumë i rëndësishëm. Këto standarde sigurojnë që karriget të jenë të sigurta, të qëndrueshme dhe të rehatshme për përdoruesit.

Ja disa arsye pse është i rëndësishëm:

Siguria: Standardet përcaktojnë kërkesat për sigurinë e karrigeve, duke minimizuar rrezikun e aksidenteve.

Komoditeti: Dimensionet dhe dizajni i përcaktuar nga standardet ndihmojnë në sigurimin e një pozicioni të rehatshëm për përdoruesit. **Qëndrueshmëria:** Standardet sigurojnë që karriget të jenë të qëndrueshme dhe të rezistojnë përdorimit të përditshëm. **Përputhshmëria:** Ndjekja e standardeve ndihmon në përputhjen me rregulloret dhe kërkesat ligjore.

Krevat femijesh : SSH EN 1130:2019/ AC:2020, standart qe perdoret per te percaktuar kerkesat ne lidhje me dimensionet qe duhet te kete nje krevat femijesh dhe gjithashtu pershkruan edhe metodat e testimeve te kryera per percaktimin e tyre. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti i prodhuar respekton keto dimensione.

SSH EN 1130:2019/ AC:2020, standart qe specifikon kerkesat qe duhet te plotesojne keto krevate per sa i perket sigurise, forces dhe qendrueshmerise per nje perdorim rreth 4 ore ne dite. Nje certifikate te tille nenkupton qe produkti eshte i sigurte per nje perdorim te tille.

Standardi SSH EN 1130:2019/AC:2020 është shumë i rëndësishëm per kete procedure prokurimi. Ai siguron që krevatët e fëmijëve të jenë të sigurt dhe të ndërtuar sipas kërkesave të rrepta të sigurisë. Kjo është thelbësore për të mbrojtur fëmijët nga rreziqet e mundshme dhe për të siguruar që produktet të jenë të cilësisë së lartë dhe të qëndrueshme.

Tavoline kopshti: EN 1729-2012+A1:2015, SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016, SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015, standart qe percakton dimensionet funksionale te tavolinave per perdorim ne institucionet parashkollore qe nga mosha 3-6+, duke bere nje klasifikim sipas ngjyrave ne perputhje me moshen dhe gjatesine e femijeve, ne menyre qe te sigurohet nje qendrim sa me rregullt i femijes.

EN 1729-2012+A1:2015, SSH EN 1729-1:2015 (EN 1729-1: 2015/ AC:2016, SSH EN 1729-2:2012 + A1:2015, standart qe percakton kerkesat e sigurise qe duhet te permbushin tavolinat per femijet per perdorim ne institucionet parashkollore si dhe pershkruan metodat e testimit qe aplikohen per te vleresuar sigurine dhe stabilitetin e keture mobiljeve.

Kërkimi i standardeve si **EN 1729-1:2015** dhe **EN 1729-2:2012+A1:2015** është i rëndësishëm për keto arsye si me poshte:

Siguria: Këto standarde sigurojnë që karriget dhe tavolinat të jenë të sigurta për përdorim në mjediset arsimore, duke minimizuar rrezikun e lëndimeve.

Ergonomia: Standardet ndihmojnë në krijimin e mobiljeve që janë të përshtatshme për përdoruesit, duke promovuar një qëndrim të mirë dhe duke reduktuar lodhjen fizike.

Konsistenca: Ato sigurojnë që mobiljet të kenë dimensione dhe cilësi të qëndrueshme, duke lehtësuar prodhimin dhe blerjen.

Përputhshmëria: Ndjekja e këtyre standardeve ndihmon institucionet arsimore të përmbushin kërkesat ligjore dhe rregullatore.

2.3.13 Në rastin kur OE nuk është prodhues i këtyre produkteve/ artikujve, ai duhet të disponojë dhe të paraqesë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë: Autorizim Prodhuesi ose Autorizim Distributori, për pajisjet e ofertuara.

Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon/fax email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

2.3.14 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshura / foto ilustruese ose cdo lloj dokumentacioni tjetër teknik, për paisjet e kërkuara duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga paisjet e ofruara me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse paisjet e ofruara janë sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit. Fleta ose fletët e katalogut/broshurës për paisjet duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuara.

Argumentim: Në bazë të pikës 6/b, të nenit të 40 të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”

Nga ana e AK janë kërkuar katalogë në përputhje me bazën ligjore të sipërpërmendur duke qenë se nëpërmjet kërkesës për dorëzim e katalogëve AK krijon siguri të plotë dhe vërteton përmbushjen e specifikimeve teknike dhe përputhshmërinë e mallrave të kërkuar me ato të ofertuar nga operatori ekonomik.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalenti i tyre

Në lidhje më afatin e lëvrimit të mallit nga ana specialistit të fushës u vlerësua se nisur nga volumi i kontratës, proceset që do kryhen (prodhim, transport, furnizim vendosje), furnizimi nëpër shkolla në Bashkinë Tiranë të përcaktuara në plan shpërndarje u caktua afati i lëvrimit prej 2 (dy) muajsh nga nënshkrimi i kontratës.

Për operatorët ekonomikë:

Shënim: Mbështetur në përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti*”

kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6 dhe 7, të këtij neni, ku parashikohet:

1. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

2. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim: Verifikimi, kontrolli për cilësinë e mallit të ofruar do të kryhet nga Komisioni i marrjes në dorëzim të mallit, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në DST

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose

shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës janë ngarkuar më vete në SPE.